



A2022053010206726011

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI ME KUSHT

Sot, më datë 07.11.2022, para meje Notere EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, RR.SAMI FRASHERI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI ,KATI 2, u paraqit personalisht:

PALA DHURUESE:

Vjollca Hoxha, atësia Shaqir, amësia Mile, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Blv.Bajram Curri; Nd. Etc; H. Shk.B; Ap. 14/7; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 23/03/1969, gjendja civile “e ve”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035435055 dhe nr. personal G95323231L,

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si “Dhuruesi”)

PRANUES DHURIMI:

Lorela Hoxha, atësia Dritan, amësia Vjollca, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Blv.Bajram Curri; Nd. Etc; H. Shk.B; Ap. 14/7; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 19/10/1993, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 027970383 dhe nr. personal J36019045D.

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si “Përfituesi i dhurimit”)
Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

BAZA LIGJORE

Neni 761 e vijues të Kodit Civil

Neni 73, pika 1, gërma “ç” (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma “ç” (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar

Neni 62, gërma “ll”, neni 63, pika 1, gërma “ç”, si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”

Shoqëria Top News, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11613001O, me adresë Rruga '17 Nentori', Nr.20, Mezez Koder, Kashar Tirane.

Dhuruesi Znj. Vjollca Hoxha, zoteruese e nje kuote qe perfaqeson 100% te pjesemarrjes ne kapitalin e pergjithshem te shoqerise, ku kapitali i shoqerise eshte ne vleren me kapital të regjistruar 100,000 (njëqind mijë) lekë, zotëruese e 1 (një) kuote, e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë; Sipas kushteve dhe afateve te percaktuara ne kete Kontrate, dhuruesja i dhuron Znj. Lorela Hoxha kuoten ne Dhurim, ne daten e nenskrimit te kesaj kontrate.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është kalimi i se drejtës se pronësisë nëpërmjet dhurimit nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit i kuotes, prej 100% (njëqind përqind) të kapitalit, që Dhuruesi zotëron në kapitalin e shoqërisë “**TOPNEWS**” shpk NUIS M11613001O, me seli në adresën: Rruga "17 Nentori", nr.20, Mezez, Koder Kashar, Tirane.

Znj. Lorela Hoxha, do te behet administratore e shoqerise dhe do te bej te mundur depozitimimin e ketij akti prane QKB.



A2022033010206726011

Duke qene se RBS e shoqerise rezulton e bllokuar, sipas RBS bashkelidhur, Znj. Lorela Hoxha njeh cdo detyrim te shoqerise dhe pranon kete dhurim kuotash bashke me barren perkatese.

NENI 2

KUSHTET E KONTRATËS

Dhuruesi i kalon pa kushte Pranuesit te Dhurimit të drejtën e pronësisë nëpërmjet dhurimit te kuotes prej 100% (njqind përçind) së kapitalit, që Dhuruesi zotëron në kapitalin e shoqërisë **“TOPNEWS” shpk NUIS M116130010**.

Me dhurimin nga dhuruesi te kuotave ne dhurim prej Znj. Vjollca Hoxha, Znj. Lorela Hoxha behet zoteruese e vetme e 1 (nje) kuote ne shoqerine e cila perben 100 % (njqinde perçinde) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pranuesi i dhurimit Znj. Lorela Hoxha eshte dakort dhe pranon te marre kuotat ne gjendjen fizike dhe juridike ne te cilen ndodhen sipas RBS bashkelidhur.

Pranuesi i dhurimit fiton pronesine mbi Kuotat, dhe te gjitha te drejtat e lidhura me pronesine, mbi Kuotat ne dhurim, ne Daten e Nenshkrimit. Pranuesit te dhurimit i lind e drejta ne daten e nenshkrimit te regjistroje pronesine e tij mbi Kuotat ne dhurim ne QKB, ne librat e Shoqerise dhe ne cdo organ tjeter kompetent.

NENI 3

QELLIMI I KONTRATES

Subjektet e termave dhe kushteve te kesaj kontrate, dhuruesi eshte dakort te dhuroje, transferoje dhe dorezoje tek pranuesi i dhurimit dhe pranuesi i dhurimit eshte dakort te pranoje dorezimin e kuotave te **“TOPNEWS” shpk**. Dhurimi i kuotave behet pa asnje kundershperblim.

Pranuesi i dhurimit do te marre te gjitha veprimet per te regjistruar kontraten e dhurimit te kuotave sic kerkohet nga ligjet e Republikes se Shqiperise per depozitimim e kesaj kontrate ne QKB te rrethit perkates

NENI 4

GARANCITË E DHURUESIT

Dhuruesi garanton Pranuesin e Dhurimit se kuota prej 100% (njqind përçind) te kapitalit, që ai zotëron në shoqërinë **“TOPNEWS” shpk NUIS M116130010**, është në pronësinë e tij.

Pronësia e Dhuresit mbi kuotat vërtetohet nëpërmjet ekstraktit të shoqërisë, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Pala dhuruese perfaqeson dhe garanton si me poshte:

Ekzekutimi i caktuar. Kjo kontrate eshte ekzekutuar nga pala pranuese e dhurimit dhe kjo kontrate konstituon detyrime te vlefshme dhe ligjerisht te detyrueshme per pranuesin e dhurimit te zbatueshme ne perputhje me termat e saj.

Pa konflikt. Hartimi i kesaj kontrate dhe perputhshmeria me termat ketu, nuk do te jete ne konflikt me /ose rezultoje ne shkelje me ndonje dispozite apo te kerkoje ndonje pelqim ose te rezultoje ne imponim te ndonje pengu, te ndonje marreveshje ose instrumenti ne te cilin dhuruesi eshte pale ose dhuruesi ose ndonje nga asetet jane te detyruar; dhe nuk do te paguaje ose nje fakt i cili me dhenien e njoftimit, kalimi i kohës ose kryerja e ndonjë përcaktimi ose ndonje kombinimi ketu, do te perbeje mospermbushje te detyrimeve te kesaj kontrate.

Dhuruesi eshte pronari ligjor dhe i vetem i kuotave, kuota te cilat jane te bllokuara sipas RBS bashkelidhur. Kjo ne baze te vertetimit leshuar nga Regjistri i Barreve Siguruese. Dhuruesi ka te drejte te dhuroje apo te prokuroje transferimin e kuotave tek pala pranuese sipas termave te pershkruara ne kete kontrate.

NENI 5

TE NDRYSHME

Cdo njoftim, aplikim, ose komunikim tjeter qe duhet dhene ose bere sipas kesaj kontrate kundrejt pranuesit te dhurimit dhe dhuresit do te behet me shkrim pervec kur parashikohet ndryshe ne kontrate. Njoftimi, kerkesa ose komunikim tjeter do te konsiderohet qe i eshte dhene ose bere kur ai do t'i dorezohet dorazi, me poste pales te ciles i kerkohet ose lejohet t'i jepet ose bere ne adresen e pales ose adrese tjeter qe pala ka caktuar, duke e njoftuar palen tjeter per te dhene apo bere njoftime te tilla , aplikime ose komunikime te tjera.



A2022053010206726011

NENI 6

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Dhuruesi zhvishet plotësisht nga pronësia mbi kuoten prej 100% (njqind përqind) të pjesës së kapitalit, që ai zotëron në shoqërinë "TOPNEWS" shpk NUIS M116130010, dhe pronar i vetëm dhe i ligjshëm i tyre bëhet Pranuesi i Dhurimit.

Qe nga ky moment Pranuesi i Dhurimit ka gjitha te drejtat e pronësisë qe ligji i njuh mbi kuotwn dhe ka të drejtë që të regjistrojë këtë kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të bërë ndryshimin e pronësië mbi kuotat.

NENI 7

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e shitjes se kuotave, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Bashkëlidhr gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PER SHOQËRINE "TOPNEWS" shpk

**DHURUESI
VJOLLCA HOXHA**

**PRANUESI I DHURIMIT
LORELA HOXHA**

**NOTER
EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)**

